



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**  
**K.P.P. 303/2016**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Gentian Këri	Kryetar
Spiro Kuro	Zv/Kryetar
Leonard Gremshi	Anëtar
Hektor Balluku	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06/05/2016 shqyrtoi ankesat me:

**Objekt:**

Shfuqizimin e vendimit KVO-së për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik "Ilar" sh.p.k. në procedurën e prokurimit "Kërkesë për Propozime" me Nr. Ref- 23478-02-11-2016 me objekt "Prodhim i formularëve dhe kartave të shëndetit" me fond limit 8,000,000 lekë (pa TVSH), procedurë zhvilluar në datën 26.02.2016, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria Rajonale e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Durrës (DRFSDKSH-Durrës)

Shfuqizimin e vendimit KVO-së për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik "Albdesign PSP" sh.p.k. në procedurën e mësipërme të prokurimit.

**Ankimues:**

"Ilar" sh.p.k.  
Adresa: Rr. "Muhamed Gjollesha" Nr.17  
Tiranë

"Adel Co" sh.p.k.  
Adresa: Rr. "Muhamed Gjollesha", Zogu i Zi  
Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:**

Drejtoria Rajonale e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Durrës (DRFSDKSH-Durrës)  
Adresa: Rruga "Bashkimi", pranë ish- Befotrofit  
Durrës

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:****I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektet e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues.

**II***Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 11.02.2016 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozime” me Nr. Ref- 23478-02-11-2016 me objekt “Prodhim i formularëve dhe kartave të shëndetit” me fond limit 8,000,000 lekë (pa TVSH), procedurë zhvilluar në datën 26.02.2016, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria Rajonale e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Durrës (DRFSDKSH-Durrës).

II.2. Në datën 26.02.2016 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 26.02.2016 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

1. “Ilar” sh.p.k.	5,000,000	lekë	skualifikuar;
2. “Albdesign PSP” sh.p.k.	6,875,000	lekë	kualifikuar;
3. “Adel Co” sh.p.k.	7,500,000	lekë	kualifikuar;
4. “Kristalina KH” sh.p.k.	7,900,000	lekë	kualifikuar;

II.3.1. Operatori ekonomik ankimes “Ilar” sh.p.k. është njoftuar për skualifikimin e ofertës së tij me argumentin se : “[...]Sasia e kerkuar nga DRSKSH nuk perkon me sasine e paraqitur ne formularin e ofertes Oferta juaj është anomalisht e ulët ;; [...]”

II.3.2. Në datën 29.02.2016 operatori ekonomikë “Ilar” sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit.

### Public Health Sector

II.3.2.1. Në ankesën drejtuar autoritetit kontraktor, pala ankimese kundërshton vendimin e KVO-së me argumentat se: “[...] Më datën 26.02.2016 ka skualifikuar operatorin “Ilar” sh.p.k. me arsyetimin se oferta jonë nuk është sipas D.Standarde dhe ofertë anomalisht e ulët. Kjo nuk qëndron sepse oferta jonë është e ndërtuar sipas rubrikës së dokumentave standarde që është shtojca 12 dhe konkretisht “Sasia dhe grafiku i lëvrimin” dhe gjithashtu ne jemi dhe importues të letrës dhe me çmimet përkatëse ne jemi me çmim konkrrekt ku kosto e formularit dhe e kartës është 60%, shpenzimet indirekte 20 % dhe fitimi 20%. Si konkluzion ne kërkojmë kualifikimin e operatorit “Ilar” sh.p.k. [...]” Gjithashtu, referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ konstatohet se krahas ankesës operatori ekonomik ka dorëzuar edhe Preventiv me të dhënat si më poshtë vijon “ Më poshtë po ju ofrojmë preventivin për këtë objekt prokurimi që bazohet në referencat, Kodi Doganor në Shqipëri:

Fletë A4 lazer bond, çmimi	X lekë
Shtypi me 4 ngjyra para mbrapa	X lekë
Totali	X lekë

Karta e shëndetit: çmimi X lekë

<i>Shtypi i kartës para mbrapa</i>	<i>X lekë</i>
<i>Plastifikimi i kartës</i>	<i>X lekë</i>
<i>Totali</i>	<i>X lekë</i>
<i>Fitimi i mundshëm</i>	<i>X lekë</i>
<i>Taksa Tatimore</i>	<i>X lekë</i>
<i>T.V.Sh.</i>	<i>X lekë</i>
<i>Totali XX lekë</i>	<i>[...]</i>

II.3.3. Në datën 09.03.2016 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.407/2 prot datë 09.03.2016 i kthen përgjigje palës ankimuese duke mos pranuar ankesën.

II.3.4. Në kthim përgjigje autoriteti kontraktor argumenton në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon: “[...]OE “Ilar” sh.p.k. ka pasur kohën e nevojshme për sqarime mbi pasaktësitë e konstatuara në shtojcën 12 të dokumenteve standarde të tenderit ashtu si çdo operator ekonomik tjetër. Gjithashtu, sasia e kërkuar është e pasqyruar dhe në shtojcën 10 “Specifikimet Teknike”. Për këtë arsye ankesa juaj nuk merret parasysh në këtë fazë. Duke vlerësuar çmimin për njësi, oferta juaj tejkalon fondin limit për këtë procedurë prokurimi. Oferta është konsideruar anomalisht e ulët bazuar në përlllogaritjen sipas DST pika 3.3. [...]”

II.4. Në datën 03.03.2016 operatori ekonomikë “Adel Co” sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Albdesign PSP” sh.p.k. në procedurën e mësipërme të prokurimit.

### Public Health Sector

II.4.1. Në ankesën drejtuar autoritetit kontraktor, pala ankimuese kundërshton vendimin e KVO-së me argumentat se: “[...] Ne kundërshtojmë këtë renditje dhe kualifikimin e shoqërisë “Albdesign PSP” pasi kjo shoqëri ka mungesë dokumentacioni duke mos plotësuar kriteret e kërkuara në DST dhe konkretisht: Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. ; Vërtetim nga organet tatimore për xhiron mesatare vjetore gjatë tre viteve të fundit financiare, kjo mesatare nuk duhet të jetë më pak se 80 % e vlerës së fondit limit të kësaj procedure prokurimi. Kjo shoqëri ka paraqitur vetëm vërtetim xhiro për vitin 2015, pra nuk e plotëson kriterin e kërkuar. Kopje e bilancit financiar të vitit 2014 të certifikuar dhe të pranuar nga autoritetet përkatëse. Operatori ekonomik “Albdesign PSP” sh.p.k. ka paraqitur vetëm bilanc për vitin 2015, pra nuk e plotëson këtë kriter. Kontrata e ngjashme e paraqitur nga ky operator ekonomik është fiktive pasi Z. E.S. pretendon se ka prodhuar 150,000 karta shëndeti dhe ja ka shitur Albdesign sh.p.k.. Nuk e dimë se cfarë kontrate është pa paraqitur asnjë model dhe kush ka qenë i interesuar. Operatori ekonomik duhet të ketë makineri parapërgatitje të tipologjisë CTP ( Computer to plate), makineri shtypi offset me minimalisht 4 (katër) ngjyra të vërtetuar me: duke paraqitur dokumentin e zhdoganimit, faturë blerje të vlefshme deri në përfundim të afatit të realizimit të kontratës. Përsa u përket faturave të zhdoganimit të makinerive të paraqitura nga kjo firmë nuk duket

qartë përmbajtja e tyre dhe nuk dihet se për çfarë është zhdoganuar. Ky kriter nuk plotësohet. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë regjistrimi të lëshuar nga organet shtetërore kompetente apo nga insitucione të pavarura që vërteton se sistemi i menaxhimit të OE është në përputhje me kërkesat e standardit ISO 9001:2008 që tregojnë se plotëson të gjitha kushtet dhe procedurat e nevojshme për të garantuar prodhim me cilësi të produktit të kërkuar. Në kërkojmë të bëhet verifikimi i kësaj certifikate. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar jo më pak se 10 ( dhjetë) punonjës për realizimin e kontratës. Për të vërtetuar këtë duhet të paraqesë Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën Qershor-Dhjetor 2015 të shoqëruar me listëpagesat e plotësuara rregullisht sipas formularit E-Sig 025/a të konfirmuara nga Dega e Tatim Taksave ku është i regjistruar, ku të jenë të pasqyruar për çdo muaj punonjësit e kërkuar. Operatori ekonomik :Albdesign PSP” nuk e plotëson këtë kriter, pasi nuk disponon numrin e caktuar të punëtorëve për periudhën qershor-dhjetor 2015 [...]”

II.4.2. Në datën 09.03.2016 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.406/2 prot datë 09.03.2016 i kthen përgjigje palës ankimese duke mos pranuar ankesën.

II.4.4. Në kthim përgjigje autoriteti kontraktor argumenton në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon: “[...]Në bazë të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar si edhe VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Rregullat e prokurimit publik”, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në përputhje me DST ka bërë vlerësimin e OE të cilët kanë paraqitur ofertë në procedurën e prokurimit me objekt “Prodhimi i formularëve dhe kartave të shëndetit”. Në shtojcën 8 të DST pika 2, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar është kërkuar “Vërtetim nga organet tatimore, për xhiron mesatare vjetore gjatë tre viteve të fundit financiare, kjo mesatare nuk duhet të jetë më pak se 80% e vlerës së fondit limit të kësaj procedure prokurimi”. Vërtetimi i Paraqitur nga OE Albdesign PSP nga organet tatimore është për xhiron e vitit 2015 ku vlera mesatare nuk është më pak se 80 % e vlerës së fondit limit të kësaj procedure prokurimi. Kjo edhe duke marrë parasysh faktin se kjo shoqëri është krijuar në vitin 2015 dhe gjithashtu duke konsideruar vitet 2013 dhe 2014 me vlerë xhiro 0, vlera mesatare e të tre viteve është më shumë se 80%. Kopje bilanci financiar të vitit 2014 të çertifikuar dhe të pranuar nga autoritetet përkatëse. Nga OE Albdesign PSP është paraqitur bilanci financiar të vitit 2015 i çertifikuar dhe i pranuar nga autoritetet kontraktore përkatëse pasi është kompani e krijuar në vitin 2015. Gjithashtu në pikën 2.3. Kapaciteti teknik është kërkuar “Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të ketë të realizuara gjatë tre viteve të fundit financiare furnizime të ngjashme, me vlerë prej jo më pak 30% të vlerës së fondit limit .Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:Vërtetime të lëshuara nga një ent publik dhe faturat tatimore të shitjes, ku të shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara .Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara. Operatori ekonomik ka paraqitur faturë tatimore furnizimi të ngjashme që plotëson kushtet e kapacitetit teknik. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar jo më pak se 10(dhjetë) punonjës për realizimin e kontratës. Për të vërtetuar këtë duhet të paraqesë Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën Qershor-Dhjetor 2015 të

shoqëruar me listë-pagesat e plotësuara rregullisht sipas formularit të përcaktuar E-SIG 025/a të konfirmuara nga Dega e Tatim Taksave ku është i regjistruar, ku të jenë të pasqyruar për çdo muaj punonjësit e kërkuar. Operatori ekonomik sipas vërtetimit të kontributeve ka mbi 30 punonjës për periudhën e qershor-shtator 2015. Për arsye të afatit të limituar për realizimin e prodhimit të formularëve dhe kartave të shëndetit, operatorit ekonomik/bashkimi i operatorëve ekonomikë duhet të sigurojë numrin e nevojshëm të punonjësve në dispozicion, në mënyrë që të sigurohet në kohë realizimi i proceseve për produktin në cilësinë dhe kujdesin e duhur sipas kërkesave të autoritetit kontraktor të përcaktuar në kontratë. Operatori ekonomik duhet të ketë makineri parapërgatitje të tipologjisë CTP (computer to plate), makineri shtypi offset me minimalisht 4 (katër) ngjyra të vërtetuar me : duke paraqitur dokumentin e zhdoganimit, faturë blerje, të vlefshme deri në përfundim të afatit të realizimit të kontratës. Bazuar në vërtetimin doganor ky kriter konsiderohet i plotësuar nga OE Albdesign PSP në përputhje me procedurën “Kërkesë për Propozim” për kontratë publike për mallra dhe konform kërkesave të përcaktuara nga AK në dokumentet standarde të tenderit. Në këtë kushte, autoriteti kontraktor, ankesën drejtuar nga ana Juaj vendosi të mos e marrë në konsideratë pasi kriteret kualifikuese të përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit dhe të plotësuara nga operatori ekonomik “Albdesign PSP” janë ligjore dhe në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që është prokuruar nga autoriteti ynë kontraktor. [...]”

II.5. Në datën 01.04.2016 me anë të shkresës nr. 540/1 protokolli autoriteti kontraktor ka dorëzuar informacionin e kërkuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Ilar” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij me argumentin se “[...]sasia e kërkuar nga DRSKSH nuk përkon me sasinë e paraqitur në formularin e ofertës [...]” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 10 “Specifikimet Teknike” të procedurës së prokurimit objekt ankimi nga akimi nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar:

***Mosplotësimi i specifikimeve përbën kusht skualifikimi.***

***Sasia : 500 000 copë formular/kartë shëndeti***

***Letër: 90 gsm Laserbond***

Ngjyra formulari: 4 nga të dyja anët

Ngjyra karta: 4 nga njëra anë

Formati i formularit: A4

Formati i Kartës: i hapur – 5.5cm x 17cm , i mbyllur 5.5cm x 8.5cm

Numër serial : duhet të ketë një numër serial unik të paraprintuar për çdo formular.

Punime: Karta duhet të jetë e inkorporuar tek formulari si pjesë perberese e saj, si edhe të ketë plastifikim parcial. Karta duhet të jetë me prerje gjysëm presioni që të mund tëhiqet lehtësisht nga formulari, të paloset dhe ngjitet.

Karta duhet të jetë e plastifikuar nga njëri krah, me plastifikim të veçantë i cili mund të printohet dhe personalizohet në pajisjet printuese të Fondit. Gjithashtu plastifikimi special duhet të bëjë të mundur që printimi i personalizimit të jetë rezistent ndaj gërvishtjeve dhe lagies me ujë.

*Përmbajtja e formularit dhe kartës së shëndetit:*

Formulari duhet të përmbajë në njërën anë të fletës logon e Fondit, fushat e kërkesës për pajisje me kartë shëndeti sipas formularit “Kërkesë për pajisje me kartë shëndeti”, kartën e inkorporuar të hapur.

1-Përmbajtja e fletës së parme të formularit konfigurimet janë bashkëlidhur.

2- Përmbajtja e fletës së pasme të formularit:

Në anën e pasme të fletës formulari duhet të përmbajë tekstin informues sipas seksionit “Përmbajtja e fletës së pasme të formularit”

Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave, Nr. 307, Datë 21.05.2014, për “Regjistrimin dhe identifikimin e personave të siguar nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor”, identifikimi i personave të siguar në skemën e sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor, bëhet me anë të kartës së shëndetit. Karta e shëndetit është dokumenti që vërteton se mbajtësi i saj është person i siguar. Karta është personale dhe e patjetërsueshme dhe shpërndahet pa asnjë pagesë apo tarifë shërbimi.

Për t’u pajisur me kartë shëndeti, personat e siguar duhet të paraqiten pranë pikave të shpërndarjes së kartës së shëndetit me dokumentat e mëposhtme:

Dokumentat për t’u pajisur me kartë shëndeti:

1. Dokumentacion identifikues:

a. Për shtetasit shqiptarë:

kartën e identitetit; për fëmijët deri në moshën 16 vjeç, në mungesë të kartës së identitetit, paraqitet çertifikata e gjendjes civile ose pasaporta, të cilat janë dokumente që përmbajnë numrin personal të identitetit.

b. Për shtetasit e huaj:

Leja e qëndrimit ose leja provizore e qëndrimit e lëshuar nga autoriteti vendor për kufirin dhe migracionin.

2. Vërtetim regjistrimi pranë mjekut të familjes ku personi është i regjistruar.

3. Dokumentacionin që vërteton kategorinë përfituese dhe afatin e përfitimit.

4. Kërkesën për t'u pajisur me kartë shëndeti.

Pas ketij informacioni vendoset tabela e kategorive përfituese bashkëngjitur.

<i>Kategoria përfituese</i>	<i>Teksti në kartë /kategoria</i>	<i>Dokumenti vërtetues</i>	<i>Afati i përfitimit</i>
<i>I punësuar</i>	<i>I punësuar</i>	<i>Libreza e kontributeve të Sigurimit Shoqëror dhe Shëndetësor. Do të konsiderohen edhe shënimet e bëra nga punëdhënësi, për raportet mjekësore, që paguhen nga ISSH.</i>	<i>1 vit nga data e lëshimit</i>
<i>I vetëpunësuar</i>	<i>I vetëpunësuar</i>	<i>Vërtetimi për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore lëshuar nga Inspektori i të Vetëpunësuarve në Bujqësi i sigurimeve shoqërore të zonës përkatëse</i>	<i>3-muaj nga data e lëshimit</i>
<i>Sigurim vullnetar</i>	<i>Sigurim vullnetar</i>	<i>Kontrata me FDSKSH Dokumenti që vërteton derdhjen e kontributit vullnetar pranë drejtorisë rajonale/degës</i>	<i>Sipas kontratës me FSDKSH</i>
<i>Fëmijë 0-12 muaj</i>	<i>0-12 muaj</i>	<i>Çertifikatë lindje</i>	<i>Nga data e lëshimit deri në moshën 12 muaj</i>
<i>Fëmijë 1-18 vjeç</i>	<i>1-18 vjeç</i>	<i>Çertifikatë lindje</i>	<i>Nga data e lëshimit deri në moshën 18vjeç</i>
<i>Student 18-25 vjeç</i>	<i>Student</i>	<i>Karta e identitetit Vërtetim nga universiteti përkatës, brënda ose jashtë vendit (i përkthyer dhe noterizuar për universitetet jashtë vendit)</i>	<i>1 -vjeçar nga data e lëshimit deri në moshën 25 vjeç</i>
<i>Kujdestar për invalidët para/tetra-plegjikë</i>	<i>Kujdestar</i>	<i>Libreza kontributeve të Sigurimit Shoqëror dhe Shëndetësor</i>	<i>Pa afat</i>
<i>Invalid i plotë</i>	<i>Invalid i plotë</i>	<i>Vërtetimi invaliditeti nga sigurimet shoqërore/ Libreza invaliditetit</i>	<i>Nga data e lëshimit të kartës deri në afatin e vërtetimit</i>
<i>Invalid i pjesshëm</i>	<i>Invalid i pjesshëm</i>	<i>Vërtetim invaliditeti nga sigurimet shoqërore/ Libreza invaliditetit</i>	<i>Nga data e lëshimit të kartës deri në afatin e vërtetimit</i>



<i>Invalid luftë</i>	<i>Invalid luftë</i>	<i>Vërtetimi invaliditeti nga sigurimet shoqërore/ Libreza invaliditetit</i>	<i>Pa afat</i>
<i>Veteran</i>	<i>Veteran</i>	<i>Statusi i veteranit/ Libreza veteranit</i>	<i>Pa afat</i>
<i>Pensionist</i>	<i>Pensionist</i>	<i>Libreza pensionit sipas kategorive të sigurimeve shoqërore</i>	<i>Pa afat</i>
<i>Pension i parakohshëm, i pjesshëm, i reduktuar</i>	<i>Pensionist i pjesshëm</i>	<i>Libreza pensionit sipas kategorive të sigurimeve shoqërore</i>	<i>Pa afat</i>
<i>Person pa pension pleqërie</i>	<i>Pa pension</i>	<i>Karta e identitetit ose çertifikata e gjendjes civile që vërteton moshën mbi 65 vjet për burrat dhe mbi 60 vjet për femrat</i>	<i>Pa afat</i>
<i>I verbër</i>	<i>I verbër</i>	<i>Libreza përkatëse e lëshuar nga drejtoria rajonale e shërbimit social shtetëror</i>	<i>Me afat sipas librezës/vendimit të komisionit.</i>
<i>Jetim</i>	<i>Jetim</i>	<i>Libreza përkatëse e lëshuar nga drejtoria rajonale e shërbimit social shtetëror</i>	<i>Sipas afatit të librezës, por jo përtej moshës 25 vjeçare</i>
<i>Përfutuese e lejes së lindjes</i>	<i>Leje lindje</i>	<i>Sipas shënimit të punëdhënësit në librezën e kontributeve</i>	<i>Me afat sipas librezës</i>
<i>Grua shtatzënë</i>	<i>Shtatzënë</i>	<i>Vërtetim i konsultorit mjeku/fëmija për periudhën e shtatëzaniës.</i>	<i>Me afat sipas vërtetimit</i>
<i>Person me aftësi të kufizuar</i>	<i>PAK</i>	<i>Vendimi i KMCAP</i>	<i>Me afat sipas Vendimit të KMCAP</i>
<i>Person që trajtohet me ndihmë ekonomike</i>	<i>Ndihma ekonomike</i>	<i>Vërtetim nga njësia e pushtetit vendor për personat e familjes që përfiton ndihmën ekonomike</i>	<i>3-mujor nga data e lëshimit të kartës së shëndetit</i>
<i>I papunë punëkërkues</i>	<i>I papunë</i>	<i>Kartela personale e punëkërkuesit të papunë, lëshuar nga zyra rajonale e shërbimit kombëtar të punësimit</i>	<i>3-mujor nga data e lëshimit të kartës së shëndetit</i>
<i>I sëmurë me Ca</i>	<i>STU</i>	<i>Përgjigja e konsultës së specializuar që vërteton diagnozën</i>	<i>Pa afat</i>
<i>I sëmurë me TBC</i>	<i>STB</i>	<i>Përgjigja e konsultës së specializuar që vërteton diagnozën</i>	<i>Një vjeçar nga data e lëshimit të kartës së shëndetit</i>

Azilkërkues	Azilkërkues	Leje – qëndrimi për të huajt nga autoriteti vendor për kufirin dhe migracionin	Nga data e lëshimit deri në afatin e qëndrimit sipas përcaktimit në lejen e qëndrimit
Person në IEVP	IEVP	Sipas dokumentit të lëshuar nga Drejtoria e IEVP	Sipas periudhës së përcaktuar në dokument
Viktima të trafikimit	RVT	Sipas listës emërore të lëshuar nga Njësia Antitrafik e Ministrisë së Brendshme	Një vjeçar nga data e lëshimit të vërtetimit
Raste të veçanta (skleroza multiple, thalasemia major, defiçit i hormonit të rritjes, gjendjet post transplantit renal, St. post aplazia medulare)	Rast i veçantë	Pergjigja e konsultës së specializuar që vërteton diagnozën	Një vjeçar nga data e lëshimit të kartës së shëndetit
Ish të dënuarit dhe të përndjekurit politikë	PP	Vërtetim për dhënie statusi i lëshuar nga Instituti i Integritetit Ish të Përndjekurve Politikë përkatësisht për grupin A1 ose B	Pa afat

**Çdo shmangie nga kërkesat e mësipërme është kusht skualifikues.[...]**

III.1.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, të formularit të ofertës të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues “Ilar” sh.p.k. konstatohet se vlera totale e ofertës ekonomike e operatorit ekonomik është në vlerën 5,000,000 lekë pa përfshirë vlerën e TVSH-së. Gjithashtu nga shqyrtimi i “Formularit të Ofertës” të dorëzuar në S.P.E. nga operatori ekonomik ankimues, rezulton se në përllogaritjen e vlerës totale të shërbimit në Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në përllogaritjen e kryer të vlerës totale operatori ekonomik “Ilar” sh.p.k. ka kryer veprimin matematikor të shumëzimit të çmimit të ofruar me sasinë prej 200,000 copë ( karta shëndeti).

III.1.3. Në seksionin II “Udhëzime për Operatorët Ekonomikë”, pika 2 “Përllogaritja e Ofertës Ekonomike”, paragrafi 2.1 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka sqaruar operatorët ekonomikë mbi mënyrën e hartimit të ofertës ekonomike si më poshtë vijon: “Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës bashkangjitur me këto DT, duke përcaktuar punët që do të realizohen, sasi të dhe çmimin e tyre për “kontratat me çelsa në dorë” dhe “çmimet fikse” për kontratat e punimeve me matje

.” Ndërsa në paragrafin 2.3. parashikohet se *“Ofertuesi duhet të shënojë në preventiv çmimet për çdo zë punimi dhe çmimin total të ofertës të të gjitha punëve, pa TVSH. Vlera e TVSH-se, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të ofertës.”* Sa më sipër, nga shqyrtimi i *Formularit të Ofertës Ekonomike* të dorëzuar nga operatori ekonomik “Ilar” sh.p.k. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se ky i fundit ka ofertuar për një sasi të ndryshme nga ajo e kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor (konkretisht për 200,000 karta shëndeti), ndërkohë që sasia e kërkuar nga autoriteti kontraktor është 2.5 herë më shumë, 500,000 karta shëndeti. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se referuar *Formularit të Ofertës* së dorëzuar nga operatori ekonomik ankimes, sasia e ofertuar nga ky i fundit nuk është në përputhje me nevojën e autoritetit kontraktor pasqyruar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

III.1.4. Në Nenin 66 ” *Shqyrtimi dhe Vlerësimi i Ofertave*” pika 4 të VKM 914/2014 ”*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar parashikohet se *“[...]Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korrigjohen në mënyrën e mëposhtme:*

*- Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumt absolute të të gjitha korrigjimeve janë më të larta ose më të ulëta se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar. - Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet fjalëve dhe shifrave, mbizotëron shuma në fjalë.[...]”*

III.1.5. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se akti normativ në zbatim të ligjit VKM 914/2014 ka parashikuar rastin e konstatimit të gabimit aritmetik nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertës dhe ky i fundit lidhet me gabime të mundshme në rast të kryerjes së veprimeve aritmetike të shumëzimit mes çmimit për njësi dhe sasisë së produkteve. Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumt absolute të të gjitha korrigjimeve janë më të larta ose më të ulëta se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se pas përlogaritjeve të kryera, referuar çmimit për njësi të ofruar nga operatori ekonomik shumëzuar me sasinë e kërkuar nga autoriteti kontraktor (500,000 karta) vlera totale e ofertës së operatorit ekonomik ankimes është më e lartë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar, madje tejkalon në disa herë vlerën e fondit limit për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.1.6. Në respekt të parimit të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve mes operatorëve ekonomikë dhe të transparencës, Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim edhe ofertat e operatorëve të tjerë ekonomikë të kualifikuar në procedurën e prokurimit objekt ankimi, ku konstatohet se referuar formularit të ofertës së dorëzuar, operatorët ekonomikë kanë dorëzuar një ofertë ekonomike për sasinë prej 500,000 kartash

shëndeti të kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor, referuar dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi. K.P.P. gjykon se në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor për kryerjen e llogaritjeve të ofertës ekonomike si edhe sasisë në total të kërkuar nga autoriteti kontraktor duhet ti ishte referuar mjetit të kërkimit të sqarimit, si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje me kërkesën e autoritetit kontraktor mbi sasinë e produkteve të kërkuar nga ky i fundit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “ [...] *Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]*”.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese nuk qëndron.

III.2. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik “Adel Co” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Albdesign PSP” sh.p.k. me argumentin se [...] *Ne kundërshtojmë këtë renditje dhe kualifikimin e shoqërisë “Albdesign PSP” pasi kjo shoqëri ka mungesë dokumentacioni duke mos plotësuar kriteret e kërkuara në DST dhe konkretisht: Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.[...]*” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, pika 1 gërma “d” të dokumentave standarde të procedurës së prokurimit objekt ankimi, nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar: “d) *Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik i regjistruar në Shqipëri*”

III.2.2. Për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “Albdesign PSP” sh.p.k.. ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike ( S.P.E.) dokumentacionin e mëposhtëm:

- i. *Vërtetim nr.844 protokollit dt.30.01.2016 lëshuar nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike me anë të të cilit vërtetohet se: Bazuar në deklaratimet e deklaruesit ( përfaqësuesit ligjor) z.E.S.vërtetojmë se kërkuesi ALBDESIGN nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratën/kontratën (me kod) XXXXXXXX, titular i së cilës/cilavë është Albdesign sh.p.k. rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për*

*faturat e energjisë elektrike, vlerë e përlllogaritur deri në datën 30.01.2016 duke përfshirë faturën koherente të muajit Dhjetor 2015 [...]*

- ii. *Aneks kontrate qeraje nr.3724 rep, dhe nr.1032 kol datë 25.09.2015 lidhur para një noteri publik me objekt “dhënie me qera e disa ambienteve për ushtrim aktiviteti” lidhur mes shoqërisë “Albdesign” sh.p.k. ( qiradhënës) dhe “Albdesign PSP” sh.p.k. qiramarrës.*

III.2.3 Në Nenin 27 “Kontrata e Mallrave”, pika 5, gërma “c” të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet që: *[...]Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon: ç) një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.”*

III.2.4. Në nenin 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me Vendimin e ERE nr.109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: *“Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.*

### Public Health Sector

Në Nenin 48, pika 4 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se *“ [...] Paraqitja e ofertave bëhet si më poshtë: b) ofertat dorëzohen në rrugë elektronike, sipas përcaktimit në aktet nënligjore [...]”*

III.2.5. Referuar korrespondencës zyrtare të Komisionit të Prokurimit Publik me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Sh.a., këtu e në vijim ( OSHEE Sh.a), në datën 15.06.2015, është protokolluar shkresa e OSHEE-së me nr. 1081/1 prot., me objekt: “Kthim përgjigje kërkesës për informacion”, për dijeni Komisionit të i Prokurimit Publik, në të cilin jepet informacioni si më poshtë:

*“[...] Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektike lëshon vërtetimet e debisë, bazuar në deklaratimet vullnetare të subjekteve kërkues të kontratave të energjisë elektrike. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektike evidenton saktësinë e dokumentacionit të paraqitur si më poshtë:*

- 1. Tërësinë e kontratave të deklaruara nga subjekti (në rast se mund të ketë kontrata të tjera të padeklaruara).*
- 2. Kontratat e furnizimit për objektet e tyre, duhet të jenë të tarifuara si private.*
- 3. Kontratat e furnizimit duhet të jenë në emër të subjektit, përveç rasteve kur ato janë*

ambiente të marra me qira.

Në rast se subjekti ka paraqitur kontrata familiare, Operatori i kërkon këtij të fundit ndryshimin e tarifimit dhe pagesën me faturën e ardhshme të diferencës së cmimt bazuar në legjislacionin në fuqi dhe kontratën e furnizimit me energji elektrike. Të gjithë operatorët që kërkojnë të pajisen me Vërtetimin e Debisë duhet të aplikojnë pranë Qendrave të KNK në të gjithë Shqipërinë dhe lëshimi do të jetë i mundur jo më vonë se pesë ditë pas kërkesës nga subjekti. Mosplotësimi i kritereve të mësipërme do të rezultojë me moslëshimin e Vërtetimit të Debisë nga Drejtoria Qendrore ose Drejtoritë Rajonale. Modeli zyrtar i lëshimit të Vërtetimit të Debisë në të gjitha rastet e statusit të Operatorëve përmbledh informacionin përkatës për rastet kur:

1. Konsumatori nuk rezulton debitor në Sistemin e Faturimit.
2. Konsumatori rezulton debitor.
3. Konsumatori rezulton debitor por ka lidhur një aktmarrëveshje për shlyerjen e detyrimeve me këste.
4. konsumatori rezulton debitor por është në proces ankimimi dhe ankesa është në trajtim nga strukturat e OSHEE-së.
5. Konsumatori rezulton debitor por vlera është e ankimuar në gjykatë.[...]"

III.2.6. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektornike, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se referuar Vërtetim nr.844 protokollit dt.30.01.2016 lëshuar nga Operatori i Shpërndarjes së Eenergjisë Elektrike, kërkuesi dhe titullari i kontratës së lidhur me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, figuron të jetë një subjekt i ndryshëm juridikë me operatorin ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, "Albdesign PSP" sh.p.k. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se akti normativ në zbatim të ligjit VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, parashikon se *strictu sensu* operatorët ekonomik për të dëshmuar se kanë shlyer të gjithë detyrimet e energjisë elektrike duhet të dorëzojnë në S.P.E. vërtetimin e lëshuar nga Furnizuesi i energjisë elektrike. Sa më sipër *ratio legis* i parashikimit të mësipërm lidhet mbi vërtetimin se operatori ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit ka shlyer të gjithë detyrimet e maturuara që rrjedhin nga kontratat e energjisë elektrike që disponon në Republikën e Shqipërisë. Nga sa më sipër, K.P.P. gjykon se me anë të vërtetimit të mësipërm në cilësinë e kërkuetit dhe të titullarit të kontratës së energjisë shfaqet një subjekt tjetër juridik. Megjithëse operatori ekonomik "Albdesign PSP" sh.p.k. ka dorëzuar një vërtetim i cili është lëshuar nga OSHEE Sh.a., si edhe një kontratë qeraje për mjedise për ushtrim aktiviteti, K.P.P. gjykon se vërtetimi i mësipërm shfaq të meta dhe në asnjë rast nuk mund të cilësohet si përmbushje e kritereve të veçanta të kualifikimit, pasi në cilësinë e kërkuetit nuk shfaqet operatori ekonomik ankimues. Fakti që operatori ekonomik ankimues ka një kontratë qeraje për mjedise me një subjekt tjetër juridik nuk pengon këtë të fundit që të kërkojë pranë Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike lëshimin e vërtetimit për shlyerjen e detyrimeve të maturuara kudo që ai ushtron aktivitet, edhe në rastet kur disponon me qera mjedise të caktuara të cilat shfaqen në cilësinë e adresës së ushtrimit të aktivitetit tregëtar, apo adresave dytësore ( nipt sekondare) të ushtrimit të aktivitetit. Akoma më tej, referuar Aneks kontrate qeraje nr.3724 rep, dhe nr.1032 kol datë 25.09.2015 lidhur para një noteri

publik me objekt “dhënie me qera e disa ambienteve për ushtrim aktiviteti” lidhur mes shoqërisë “Albdesign” sh.p.k. ( qiradhënës) dhe “Albdesign PSP” sh.p.k. qiramarrës në nenin 3 të kësaj kontrate parashikohet se “Qiramarrësi do ti paguajë qiradhënësit vlerën e të gjithë faturave të energjisë elektrike dhe të ujit sipas kontratave [...]”. Sa më sipër, të ndodhur në këto kushte, subjekti tjetër juridik për të cilin është dorëzuar vërtetimi nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, nuk mund të shfaqet në cilësinë e kërkuesit mbi lëshimin e vërtetimit të lëshuar nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike. Sa më sipër, për shkak të të metave të konstatuara, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se me anë të dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, operatori ekonomik “Aldesign PSP” sh.p.k. nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit në drejtim të dorëzimit të një vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për të gjithë kontratat e lidhur në Republikën e Shqipërisë.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimues “Adel Co” sh.p. mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Albdesign PSP” sh.p.k. në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm qëndron dhe operatori ekonomik “Albdesign PSP” sh.p.k. nuk përmbush kriteret e veçanta të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P. mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

### **Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Ilar” sh.p.k për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime” me Nr. Ref- 23478-02-11-2016 me objekt “Prodhim i formularëve dhe kartave të shëndetit” me fond limit 8,000,000 lekë (pa TVSH), procedurë zhvilluar në datën 26.02.2016, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria Rajonale e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Durrës (DRFSDKSH-Durrës).
2. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Adel Co” sh.p.k. për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Aldesign PSP” sh.p.k dhe të korrigjojë shkeljet, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.

4. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Adel Co” sh.p.k.
6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**Nr. 590 Protokolli; Datë 18.03.2016;**

**Nr. 595 Protokolli; Datë 18.03.2016;**

